



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

05-10-2012	
01-013/1196	

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12.2 pika 2, nenit 17 pika f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 36 paragrafi 2 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 03.10.2012 miraton këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË AUTO PARKINGJEVE NË
QYTETIN E VITISË OVL TË UÇK-SË DEGA NË VITI

Neni 1

Objekt i këtij vendimi është dhënia në shfrytëzim i auto parkingjeve të shënuara në qytetin e Vitisë Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së dega në Viti.

Neni 2

Qëllimi i këtij vendimi është që auto parkingjet e qytetit si resurse t'u jepen në dispozicion OVL të UÇK-së, për funksionimin e tyre dhe për asistencë më të mirë të familjeve të Dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës si dhe për institucionalizimin e raporteve në mes të OVL-së së UÇK-së dega në Viti dhe Komunës së Vitisë.

Neni 3

Obligimet e Komunës

Komuna e Vitisë merr për obligim që t'u jep në shfrytëzim auto parkingjet në qytet ashtu si është precizuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Vitisë 01. nr 013/1475 të datës 11.05.2011 dhe të krijoj kushte normale për punë në këto auto parkingje.

Obligimet e OVL-së së UÇK-së, dega në Viti

OVL e UÇK-së dega në Viti merr për obligim:

1. Kujdesi për pastërtinë e auto parkingjeve dhe hapësirave të gjelbëruara për rreth.
2. OVL e UÇK-së obligohet për punësimin e punëtorëve sipas nevojës dhe nuk mund të largohet nga puna deri sa para organeve komunale nuk sjellin argumente të qëndrueshme për shkelje të obligimeve të punës.
3. OVL e UÇK-së obligohet që të mirëmbaj shënimin horizontal të auto parkingjeve.
4. Nga të hyrat e grumbulluara e mjeteve 120 Euro në muaj do të derdhen në buxhetin e komunës.
5. Për parkingjet e rezervuara dhe me pagesë mujore OVL-ja duhet të bëjë marrëveshje me DSHP-në.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1 Drejtorisë për Shërbime Publike
2 Shërbimit të Kuvendit
3 Arkivit

